



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 82-të të mbajtur më 14.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-1443/1 të datës 27.02.2020, me pretendime kundër -----
-----, HIDHET POSHT

KSHPK-ja konstatoi se në pajtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, nuk ka elemente për veprim kompetent për arsye të së cilës në denoncimin e dorëzuar nuk ka pretendime të qarta ose sugjerime për veprime të paligjshme ose të palejueshme të personave zyrtar gjatë kryerjes së detyrave dhe kompetencave zyrtare, dhe pretendimet e nxjerra nuk japin donjë bazë për të vepruar në përputhje me kompetencat e KSHPK-së.

Lënda me numër 12-1443/1 të datës 27.02.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e Komisionit shtetërorë në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e miratimit

Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur më 27.02.2020 është dorëzuar denoncim me pretendime kundër gjykatësit ----- dhe është formuar lënda me numër 12-1443/1 të datës 27.02.2020.

Në denoncim parashtruesi thekson se gjyqtari ----- i ----- ka përpiluar procesverbal para se të mbahen seancat, me arsyetimin se ai vepron në atë mënyrë për mungesën e kushteve teknike që procesverbali të mbahet në ton. Parashtruesi kërkon që KSHPK-ja të marrë masa për vendosjen e një detyrimi ligjor që çdo seancë të regjistrohet me audio, gjë që do të mundësonte që vendimet e gjykatës të jenë rezultat i respektimit të rregullave procedurale.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arriti në përfundimin se raporti përmban pretendime të përgjithshme, nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme ose të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e pushteteve publike dhe detyrave zyrtare dhe konstatoi se pretendimet e paraqitura nuk tregojnë për shkelje të dispozitave të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, pas së cilës ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

përgatiti: J:C

miratoi: K.N, anëtar i KSHPK-së

КОМИСИОНИ СШТЕТЌОРОЌЕ
ПЌР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
Nënkryetar
Katica Nikolovska

